

E drejta e informimit 2020 – Informimi në kohë krize dhe problemet e tjera të zakonshme

Edhe për vitin 2020, Res Publica ka vijuar të monitorojë zbatimin e te drejtes se informimit. Raporti është pjesë e një projekti të mbështetur nga National Endowment for Democracy, i cili konsiston në permiresimin e lirise se shprehjes dhe te drejtes se informimit të qytetareve shqiptare.

Viti 2020 ishte një vit i ngarkuar me probleme të një natyre të pazakonte për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid19, dhe për këtë arsye Res Publica u fokusua në mënyrë të vecante në standardet ndërkombetare të zbatimit të te drejtes se informimit në kohë krizash. Këshilli i Evropës u identifikua si organizmi që ka prodhuar standardet më konkrete në këtë aspekt.

Megjithatë problematiken e vecante, gjatë 2020 nuk u la pas dorë monitorimi i punës së Komisionerit për të Drejten e Informimit, si dhe pati disa risi që vijnë nga praktika e Gjykatës Administrative.

Raporti sjell shifra krahasuese me periudhat e mëparshme (vitet 2015-2019), për të shfaqur në mënyrë konkrete dhe vizive përmes grafikëve permiresimin apo përkeqesimin e treguesve konkretë. Në përgjithësi vihet re se po “normalizohen” standarde mediokre të zbatimit të ligjit, si dhe po hedhin rrenjë disa elemente të rinj demtues në praktikën e institucioneve. Gjykatat kanë qenë pozitive në trajtimet e rasteve, por Komisioneri për të Drejten e Informimit nuk po funksionon sipas kërkesave të ligjit. Për më tepër, të dhënat e raporteve zyrtare shtremberojnë me shumë

kete peizazh, duke bere qe organet politikeberese te mos kene sinjalet e duhura per nivelin e dobet dhe alarmant te zbatimit te te drejtes se informimit. Keto, por edhe gjetje te tjera qe flasin per problematika te vecanta, jane bere pjese e studimit te plote, te cilin mund ta shkarkoni ketu.